

## ABSTRAKT

Ky punim trajton zhvillimin historik dhe juridik të Bosnjë-Hercegovinës në kontekstin e Marrëveshjes së Dejtonit dhe ndikimin e saj në sovranitetin dhe funksionimin e shtetit. Në kapitullin e parë paraqitet sfondi historik, duke analizuar faktorët që çuan në konfliktin në Bosnjë-Hercegovinë.

Kapitulli i dytë shqyrton planet paqësore ndërkombëtare që i paraprinë Marrëveshjes së Dejtonit, duke vlerësuar ndikimin e tyre në formësimin e zgjidhjes përfundimtare. Kapitulli i tretë fokusohet në vetë Marrëveshjen e Dejtonit, strukturën e saj dhe ndikimin në arkitekturën kushtetuese të Bosnjë-Hercegovinës.

Në kapitullin e katërt analizohet koncepti i sovranitetit në të drejtën ndërkombëtare, me theks të veçantë në rastin e Bosnjë-Hercegovinës dhe kufizimet që i janë imponuar përmes marrëveshjeve ndërkombëtare. Kapitulli i pestë vlerëson funksionimin e Bosnjës pas Dejtonit, duke theksuar sukseset dhe dështimet në ndërtimin e institucioneve shtetërore, procesin e demokratizimit dhe integrimin në strukturat euroatlantike. Në kapitullin e gjashtë, punimi trajton perspektivat e Bosnjë-Hercegovinës, sfidat aktuale dhe rrugën e saj drejt integritimit evropian dhe stabilitetit afatgjatë.

Në përfundim, punimi ofron një analizë krahasuese të Marrëveshjes së Dejtonit me zgjidhje të tjera të konflikteve ndërkombëtare, duke identifikuar mësimet që mund të nxirren nga ky rast. Gjithashtu, paraqiten rekomandime për reformimin e strukturave shtetërore dhe forcimin e stabilitetit të Bosnjë-Hercegovinës në të ardhmen.

**Fjalë kyçe:** Marrëveshja e Dejtonit, Bosnjë-Hercegovina, sovraniteti, e drejta ndërkombëtare, konflikti, ndërtimi i paqes, integrimi evropian.